



**UNIVERSITETI I MITROVICËS**  
**UNIVERSITY OF MITROVICA**  
**"ISA BOLETINI"**

Rr. Ukshin Kovaqica, Mitrovicë, Republika e Kosovës  
Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Senatit  
Prof. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 484/004  
Dt 26.03.2019

Në bazë të nenit 48, pika 1.3, të Statutit të Përkohshëm, Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 19.3.2019, mori:

**VENDIM**

- I. Refuzohet si e pabazë ankesa e Rifat Morinës me nr. 1313 të datës 02.10.2018, e paraqitur kundër vendimit të Senatit për rizgjedhjen e tij në titullin profesor asistent për lëndët: Biokimia e përgjithshme; Proceset bioteknologjike në industrinë ushqimore; dhe Gjenetika molekulare, në bazë të konkursit të shpallur më 16.06.2017 nga Universitetit i Mitrovicës "Isa Boletini".
- II. Vërtetohet në tërësi raporti i Këshillit të Fakultetit dhe vendimi i Senatit me nr. prot. 1232 të datës 14.09.2018, për rizgjedhjen e Rifat Morinës në titullin profesor asistent për lëndët: Biokimia e përgjithshme; Proceset bioteknologjike në industrinë ushqimore; dhe Gjenetika molekulare në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".

**Arsyetim**

Universiteti i Mitrovicës ka shpallur konkurs për zgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët: Biokimia e përgjithshme; Proceset bioteknologjike në industrinë ushqimore; dhe Gjenetika molekulare në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".

Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 19.03.2019, duke pasur parasysh se propozimi i Komisionit për ankesa dhe parashtresa nuk ishte marrë në përbërje të plotë dhe nuk ishte i bazuar në Statut, por në formular, i cili nuk e ka fuqinë juridike të Statutit, u pajtua plotësisht me propozimin e Këshillit të Fakultetit Komisionit të Studimeve, sepse kandidati nuk i plotëson kriteret e parapara me nenin 156, pika 1.2 të Statutit për t'u avancuar në titullin profesor i asocuar për lëndët e lartpërmendura. Në bazë të kësaj që u tha më sipër, Senati vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, MASHT-it.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Të përmendurit;
3. Fakultetit;



Prof. dr. Alush Musaj

Kryesues i Senatit